



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 14 qershor 2013
Nr. ref.:RK423/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 129/12

Parashtrues

Nezir Bytyqi

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë
së Vendimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 204/2008 të 29 gushtit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtruesi i kërkesës është Nezir Bytyqi me vendbanim në Prishtinë. Ai përfaqësohet nga Florim Shefqeti, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Vendimin e Gjykatës Supreme Rev. Nr. 204/2008 të 29 gushtit 2011. Parashtruesi i kërkesës pohon se atij vendimi i është dorëzuar më 24 shtator 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i lartpërmendur i kishte shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, në veçanti të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 31. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkeljen e nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], dhe nenit 106.2 [Papajtueshmëria] të Kushtetutës. Për më tepër, Parashtruesi pretendon shkeljen e nenit 7 dhe 10 të Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për mbrojtjen e Drejtave të Njeriut.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe rregullin 56, paragrafi 2, i Rregullores së Punës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 dhjetor 2012, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 10 janar 2013, Kryetari caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.
7. Më 4 mars 2013, kërkesa iu komunikua Gjykatës Supreme.
8. Më 4 mars 2013, është kërkuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë që të sigurojë një kopje të konfirmimit të pranimit, e cila e tregon datën kur Vendimi i Gjykatës Supreme Rev.Nr.204/2008, të 29 gushtit 2011, i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës.
9. Më 7 mars 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë e dorëzoi një kopje të konfirmimit të dorëzimit, duke treguar se Vendimi i Gjykatës Supreme Rev. Nr. 204/2008, të 29 gushtit 2011, i është dorëzuar avokatit Naim Haliti më 17 tetor 2011.
10. Më 14 mars 2013, është kërkuar nga parashtruesi i kërkesës të sqarojë dallimin në mes të datës së dorëzimit të Vendimit të Gjykatës Supreme Rev. Nr. 204/2008, siç është treguar në Kërkesë si dhe siç ishte dorëzuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

11. Më 28 mars 2013, Parashtruesi e parashtroi përgjigjen e tij.
12. Më 15 maj 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues zëvendësues të gjyqtarit Robert Carolan në Kolegjin shqyrtues. Kolegji shqyrtues përbëhet nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
13. Më 15 maj 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Faktet e rastit

14. Prej 21 majit 1992, parashtruesi i kërkesës ishte në marrëdhënie të punës me kohë të pacaktuar me *NSH Tregu* në Prishtinë. Parashtruesi ishte i punësuar si inkasant. Më 22 mars 1999, për shkak të luftës në Kosovë, parashtruesi kishte ikur dhe kishte shkuar në kampin e refugjatëve në Turqi.
15. Në shtator 1999, parashtruesi ishte kthyer në Prishtinë dhe ishte lajmëruar menjëherë në vendin e punës. Si duket, kjo nuk ishte e mundur në atë kohë. Rrjedhimisht, më 22 qershor 2000, parashtruesi i kërkesës paraqiti një kërkesë me shkrim për t'u kthyer në vendin e tij të mëparshëm të punës. Më 28 qershor 2000, kjo kërkesë ishte refuzuar. Parashtruesi paraqiti kërkesë në Gjykatën Komunale në Prishtinë, për kthim në punë në *NSH Tregu* në Prishtinë.
16. Më 8 gusht 2000, (Cl.nr.29/2000), Gjykata Komunale e refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës. Ky vendim ishte nxjerrë nga trupi gjykues prej një gjyqtari, G. S., dhe dy gjyqtarëve porotë.
17. Më 30 tetor 2001, (Cl.nr. 302/2001), Gjykata Komunale refuzoi përsëri padinë e parashtruesit, këtë herë nga një gjyqtar i vetëm, G. S.
18. Më 18 tetor 2004, (Ac.nr. 86/2002), Gjykata e Qarkut në Prishtinë urdhëroi rigjykimin e rastit.
19. Më 29 qershor 2005, (Cl.nr. 375/2004), Gjykata Komunale në Prishtinë e refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës, pas rigjykimit.
20. Më 4 shkurt 2008, (Ac.nr. 676/2006), Gjykata e Qarkut e ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe urdhëroi kthimin e parashtruesit në vendin e tij të punës.
21. Më 11 qershor 2009, (Cl.nr. 237/2008), Gjykata Komunale në Prishtinë në procedurën epërmbarimit, të bazuar në aktgjykimin e fundit të Gjykatës së Qarkut, e urdhëroi *NSH Tregu* t'ia paguajë parashtruesit pagat e parealizuar, të plotësuara me kamatë ligjore.
22. Më 29 gusht 2011, (Rev.Nr.204/2008), Gjykata Supreme shpalli të bazuar revizionin që ishte ushtruar nga *NSH Tregu* kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut AC.nr.676/2006. Gjykata Supreme e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale të 29 qershorit 2005, (Cl.nr. 375/2004), me të cilin nuk kërkohej nga

NSH Tregu t'a kthejë parashtruesin në vendin e tij të punës. Njëri nga tre gjyqtarët e trupit gjykues të Gjykatës Supreme ishte G. S.

23. Më 4 shtator 2012, (AC.nr. 1144/2009), Gjykata e Qarkut në Prishtinë, në procedurën e përmbarimit ndaj ankesës, vërtetoi aktgjykimin për përmbarim të Gjykatës Komunale të 11 qershorit 2009, duke urdhëruar *NSH Tregu* ti paguajë parashtruesit pagat e parealizuara me kamatë ligjore.

Argumentet juridike të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës

24. Në substancë, parashtruesi i kërkesës pretendon se ai nuk ka përfituar nga gjykimi i drejtë dhe i paanshëm gjatë vendosjes në lidhje me padinë e tij. Në veçanti, parashtruesi i kërkesës pretendon se prania e gjyqtarës së njëjtë (G. S.) në dy procedura të Gjykatës Komunale dhe në trupin gjykues të Gjykatës Supreme të Kosovës, qon në përfundimin se gjykatat nuk kishin qenë të paanshme.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

25. Gjykata Kushtetuese, për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
26. Gjykata duhet të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat sipas nenit 113 (7) të Kushtetutës dhe nenit 47 (2) të Ligjit.

27. Neni 113, paragrafi 7 parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

28. Vendimi përfundimtar në rastin e parashtruesit përkitazi me kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese është Vendimi i Gjykatës Supreme (Rev.nr.204/2008) i 29 gushtit 2011. Si rezultat, parashtruesi ka treguar se ai i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas ligjeve në fuqi.
29. Parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë se ai i ka plotësuar kriteret e nenit 49 të Ligjit, në lidhje me parashtrimin e kërkesës brenda afatit ligjor. Siç u tha më lart, vendimi përfundimtar në lidhje me rastin e parashtruesit është Vendimi i Gjykatës Supreme (Rev.nr. 204/2008), të 29 gushtit 2011. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 12 dhjetor 2012.
30. Gjykata vëren se konfirmimi i dorëzimit tregon se Vendimi i Gjykatës Supreme (Rev.nr. 204/2008), të 29 gushtit 2011, i ishte dorëzuar avokatit Naim Haliti më 17 tetor 2011.

31. Më 28 mars 2013, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një shkresë Gjykatës, duke theksuar se më 17 tetor 2011 Vendimi i Gjykatës Supreme (Rev.nr.204/2008) i ishte dorëzuar Naim Halitit, i cili nuk ishte përfaqësues i autorizuar ligjor i parashtruesit në procedurën e Gjykatës Supreme, por ai thjesht ishte angazhuar për *“hartimin e revizionit.”* Parashtruesi i kërkesës thekson se ky Vendim i Gjykatës Supreme, në fakt, i ishte lënë te dyert e banesës së tij më 23 shtator 2012. Parashtruesi i kërkesës kërkon që data 23 shtator 2012 të konsiderohet si datë e dorëzimit të vendimit përfundimtar në lidhje me këtë rast, dhe prandaj afati prej katër muajve fillon të rrjedhë nga kjo datë.
32. Gjykata vëren se avokati Naim Haliti ishte shënuar në aktgjykimin e Gjykatës Supreme të 29 gushtit 2011 si përfaqësues i parashtruesit të kërkesës. Për më tepër, Gjykata vëren se avokati i njëjtë ishte shënuar në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të 4 shkurtit 2008 si përfaqësues i parashtruesit të kërkesës dhe ky avokat gjithashtu është shënuar si përfaqësues i parashtruesit në aktgjykimin e Gjykatës Komunale të 29 qershorit 2005.
33. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se dorëzimi i aktgjykimit të Gjykatës Supreme (Rev.nr. 204/2008), të 29 gushtit 2011, avokatit Naim Haliti, është i bazuar në përfundimin tërësisht të arsyeshëm se ky avokat në fakt, është përfaqësues i autorizuar i parashtruesit të kërkesës. Për më tepër, përveç deklaratës së parashtruesit të kërkesës se Naim Haliti nuk ishte përfaqësues i tij i autorizuar, nuk është paraqitur asnjë dëshmi tjetër për ta mbështetur këtë pohim.
34. Si përfundim, Gjykata konstatoi se vendimi përfundimtar në rastin e parashtruesit të kërkesës i ishte dorëzuar në mënyrë ligjore më 17 tetor 2011. Kërkesa ishte dorëzuar më 12 dhjetor 2012, që është gati 14 muaj pas datës së dorëzimit të vendimit përfundimtar në rastin e parashtruesit të kërkesës.
35. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa nuk është dorëzuar brenda afatit katër mujor të përcaktuar me Ligj dhe Rregullore të Punës, dhe duhet të refuzohet si e paafatshme.
36. Rrjedhimisht, për arsyet e cekura më lart, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës, më 14 qershor 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

